

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit BSc në Inxhinieri Industriale
Ofruar nga Kolegji Universitar "Instituti Kanadez I Teknologjisë"

Ekspertë të vlerësimit të jashtëm:
Prof. Dr. Andonaq Londo Lamani
Dr. Aleksandër Petre



(Qershor/ 2018)



RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit BSc në Inxhinieri Industriale

Ofruar nga Kolegji Universitar "Instituti Kanadez I Teknologjisë"

Tabela e të dhënave të licencimit për programin e studimit:		
1	IAL Aplikues:	Kolegji Universitar "Instituti Kanadez I Teknologjisë"
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti I Inxhinierisë
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	VKM Nr 781, datë 10.11.2011
4	Titulli i programit të studimit:	Bachelor në Inxhinieri Industriale
5	Cikli i studimit:	Cikli I Parë
6	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
7	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
8	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
9	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Angleze
10	Programi ofrohet nga institucioni	Ofrohet nga Institucioni
11	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
12	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
13	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
14	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 6 (gjashtë)
15	Aktivizimi i programit të studimit	2011-2012
16	Brezi i parë i diplomimit të studentëve	Nuk ka studentë të diplomuar
17	Numri i Studentëve	17 studentë
	etj	

Shënim:

Verifikimi ligjor sipas pikave si më sipër kryhet paraprakisht nga specialist/ët e APAAL që ndjekin këtë vlerësim

HYRJE

I gjitha Raporti I Vlerësimit të jashtëm është mbështetur në hartimin e tij në Dosjen e Vetëvlerësimit (DVV) që ka paraqitur Kolegji Universitar “Instituti Kanadez I Teknologjisë” (KUIKT), vizitës dy ditore në Institucion të realizuar më 12 dhe 13 Prill 2018, materialeve /dokumentave të shlytuara gjatë kësaj vizite, si dhe anekseve që shoqëronin DVV

Programi i Studimit Bsc në “Inxhinieri Industriale” është licensuar me VKM nr 781, datë 20.11.2011 “Për licensimin e Shkollës së Lartë Universitare private “Instituti Kanadez I Teknologjisë”, Tirane”. Me Urdhër të MASH Nr 68, datë 27.02.2012 është lejuar fillimi I veprimtarisë akademike në përputhje me licensën e dhënë për këtë program studimi. Sipas këtij Urdhëri veprimtaria akademike do të fillojë në vitin akademik 2011-2012.

Sipas drejtuesve të Institucionit, por mbështetur edhe në të dhënat e marra në Sekretarinë mësimore, në vitin akademik 2011-2012 nuk ka patur student të regjistruar në këtë program studimi. Në vitin akademik 2012-2013 është regjistruar vetëm 1 student I cili ka ndjekur vetëm një vit akademik dhe në vitin akademik 2013-2014 nuk ka patur sërishat kërkesa nga studentët për tu regjistruar në këtë program. Sipas Drejtuesve të Institucionit, synimi dhe strategjia e Institucionit ishte që mos të ofronte vetëm programe të ciklit të parë me këtë emërtim, pasi kjo mund të sillte një pengesë për studentët për thellimin e njohurive të tyre edhe në ciklin e dytë. Për këtë qëllim në vitin 2012 është licensuar programi I studimit Msc në “Inxhinieri Industriale”. Megjithatë ky program ishte I ri në tregun shqiptar dhe për këtë arsye edhe nuk kishte kërkesa për regjistrim. Orientimi I programit nga tregu shqiptar dhe rritja e kërkesës së studentëve, ka inicuar rishikimin e kurikulës së këtij programi nga një grup pedagogësh nga Fakulteti I Inxhinierisë dhe për këtë qëllim është dërguar në MASR programi I ri I rishikuar I cili mund të vihet në funksion të studentëve (kjo në varësi të përgjigjes nga MASR) në vitin e ri akademik 2018-2019.

Aktualisht programin e studimit Bsc në inxhinieri Industriale e ndjekin 17 studentë. Programi I studimit ka patur si kriter hyrës notën mesatare dhe njohuritë në gjuhën angleze. Programi ofrohet në gjuhën angleze

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

- Prof. Dr. Andonaq Londo Lamani
- Dr. Aleksandër Petre

Koordinatorë teknike e ndjekjes së këtij programi studimi është Suela Kromidha nga ASCAL. Më datë 11.06.2018 me shkresë nr 88/5 prot, “Dërgohet Draft Raporti i Vlerësimit të Jashtëm”, është dërguar në Institucion Draft RVJ. Ky Draft është dërguar edhe nëpërmjet sistemit AMS. Më datë 13.06.2018, me nr 88/6 prot “Përgjigje shkresës suaj Nr 88/5, datë 11.06.2018, “Dërgohet Draft Raporti i vlerësimit të jashtëm”, Kolegji Universitar “Instituti Kanadez I Teknologjisë shprehet dakord me këtë Draft duke mos paraqitur asnjë koment. Për këtë arsye, Raporti merr formën e tij përfundimtare.

ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektiveve dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Objektivi kryesor i hapjes së këtij programi studimi është përgatitja e specialistëve të lartë të nivelit bachelor në fushën e inxhinierisë industriale, të aftë për t'ju përgjigjur sfidave dhe detyrave që shtron sot ekonomia shqiptare dhe ajo rajonale në këto fusha. Ky objektivi është materializuar në strategjinë e këtij institucioni, e cila synon nëpërmjet planit mësimor bashkëkohor dhe programeve mësimore të arrijë objektivat e studimit. Inxhinieria industriale është një diplomë duale dhe ndërthur njohuritë inxhinierike me ato industriale dhe menaxheriale. Hartuesit e kësaj diplome kanë patur për objektivi afatgjatë që specialisti që perfundon këto studime të ketë njohuri të konsoliduara në formimin bazë të shkencave të natyrës; në formimin inxhinierik si edhe në aspektin aplikativ dhe menaxherial.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Industriale” ofrohet nga Kolegji Universitar IKT (Instituti Kandez i Teknologjise). Ky program është në përputhje me qëllimet dhe misionin e IKT për përgatitjen e studentëve në këtë fushë për t'ju përgjigjur sfidave të zhvillimit ekonomik në Shqipëri dhe në tregun europian. Studentët që përfundojnë këtë program studimi kanë një formim të qëndrueshëm në fushën e inxhinierise industriale, degë e cila ndërthurur inxhinierinë me fusha të ndryshme të ekonomisë dhe industrisë.</p> <p>Objektivat e programit të studimit janë të qarta dhe realizimi i tyre sigurohet nga i) një staf i motivuar i cili shpreh kopetencë profesionale në fushat specifike; ii) nga një infrastrukturë moderne dhe e mjaftueshme; iii) laboratorë modestë ku materializohen njohuritë praktike; iv) krijimin e një mjedisi atraktiv për zhvillimin eficient të aftësive. Në KUIKT, një mundësi që të realizohet programi i studimit është përveç sa përmendëm më lart edhe klima e bashkëpunimit midis anetarëve të stafit dhe studentëve, parë kjo si në aspektin mësimor ashtu edhe të kërkimit.</p> <p>Ky program studimi, sic rezulton nga materialet që GVJ studioi gjatë ditëve të qëndrimit në të ashtu si edhe nga vizita dhe konceptet tona si Ekspertë të vlerësimit por edhe të fushës, rezulton në përputhje me kërkesat aktuale dhe perspektive të tregut të punës sidomos në kuptimin rajonal dhe europian.</p> <p>Në Shqipëri, tregu aktual karakterizohet nga prodhimi i vogël dhe kjo krijon ndoshta hapësira jo të konsiderueshme për punësimin e specialistëve të inxhinierisë industriale por, duke konsideruar tregun e hapur rajonal dhe europian, globalizimin e ekonomisë dhe</p>

	<p>perspektivën e shqiperisë për tu integruar në BE, konsiderojmë që ky program studimi është actual. <i>Referencë: "Rregullore Mësimore e Programit të Studimit Bachelor në Inxhinieri Industriale", Objektivat e programit, pika 3.3, fq. 5.</i></p>
<p>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit; Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme; Kriteri 3 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në Inxhinierinë Industriale përputhet me strategjinë e zhvillimit të KUIKT. Programi përputhet dhe me emërtimin e institucionit dhe me synimin për të ofruar studime të ciklit të parë dhe të dytë në fushën e inxhinierisë.</p> <p>Programi i studimit, Bachelor në Inxhinieri Industriale i pajis studentët me njohuri bazë të përshtatura për ciklin e parë të studimeve dhe konkretisht:</p> <ol style="list-style-type: none"> Njohuri dhe koncepte bazë të fushës inxhinierise industriale; Aftësi drejt një profesioni apo licence profesionale; Formim qytetar të përgjithshëm; Aftësi bazë për punë kërkimore; Aftësi të përgjithshme praktike, aplikative; Aftësim për promovim personal; Aftësim për të ndjekur në mënyrë të pavarur zhvillimet teknologjike në të ardhmen. <p>Të diplomuarit në këtë program studimi formohen për profesione/mundësi punësimi në çdo sektor të inxhinierisë industriale, në menaxhimin e njohjen e funksionimit të sistemeve të operimit, atë të mirëmbajtjes së tyre, në sektor drejtues të inxhinierisë industriale, në sitemet e automatizimit, prodhimit te integruar, analizës statistikore të prodhimit etj</p> <p><i>Referencë: "Rregullore Mësimore e Programit të Studimit Bachelor në Inxhinieri Industriale", Objektivat e programit, pika 3.3, fq. 5.</i></p>
<p>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</p>	
<p>Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar; Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Ky program i nivelit Bachelor ne "Inxhinieri Industriale" nuk është ofruar deri tani nga asnjë IAL publik apo privat qoftë, në Shqipëri. Ekonomia shqiptare, ndonëse jo me prodhim masiv dhe konkures ka nevojë për specialisët të tillë. Një mungese të tillë i përgjigjet ky program studimi që ofrohet nga IKT. Programi është një vlerë e shtuar dhe një mundësi e mirë për studentët që të njiheshin me inxhinierinë industriale, si dhe t'i ofronte aktorëve të industrisë dhe biznesit specialistët e duhur, me formimin përkatës.</p> <p>GVJ konstatoi se IKT përpara se të hapte këtë program studimi ka bërë një studim tregu, ka vlerësuar nevojat e tij, planet dhe perspektivat e zhvillimit të ekonomisë</p>

shqiptare dhe europiane, duke hartuar një plan fizibiliteti të detajuar në të cilin janë përfshirë kryesisht tregu i punës, oferta akademike, parashikimi i përafërt i numrit të pritshëm të studentëve etj. Edhe në Strategjinë e zhvillimit dhe Biznes Planin e IKT reflektohet e njëjta gjë si më sipër. Aty pasqyrohet qartë objektivat në hapjen e këtij programi zhvillimi, strategjinë e realizimit të këtij objekti dhe taktikat që do të ndiqen si nga ana e përmbytjes së planit mësimor, hartimit të programeve të lëndëve që përbëjnë këtë plan dhe infrastruktura e nevojshme.

Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.

Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;
Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.

GVJ është i bindur se programi i studimit Bachelor në Inxhinierinë Industriale, nuk është në kundërshtim me interesat kombëtare dhe plotëson kriteret e këtij standardi; ai është në mbështetje të zhvillimit dhe mbrojtjes së interesave kombëtare. Ky program studimi do të shërbejë përgatitjes së specialistëve që do të jenë të aftë jo vetëm të njohin aspektet inxhinierike të prodhimit por edhe ato të automatizimit industrial që kanë të bëjnë me rritjen e rendimentit të prodhimit dhe uljen e kostos së prodhimit. Specialistët e lartë që përgatiten në këtë program studimi do të shërbejnë jo vetëm interesave kombëtare por edhe do të krijojnë mundësi punësimi të tyre në rajonin ballkanik dhe atë europian.

Programet e ofruara nga IKT synojnë në formimin e specialistëve të aftë të menaxhojnë me sukses procesin e prodhimit modern të integruar, kulturën e prodhimit, plotësimin e kërkesave ambientale. Lidhur me këtë në program janë futur lëndë të rëndësishme si “Psikologjia” dhe “Etika” si dhe seminare të vazhdueshëm lidhur me edukimin e ndërgjegjshëm qytetar të studentëve. Studentët marrin njohuri nëpërmjet intershipeve dhe praktikave mësimore për kulturën kombëtare të prodhimit; komunikimit; etikës dhe bërjes së biznesit

Konkluzione të GVJ:

Takimi i parë u realizua me Dekanin e Fakultetit Prof. Dr Sokol Abazi dhe përgjegjësin e Departamentit Phd Afrim Alimeti. Të dy drejtuesit bënë një paraqitje të shkurtër të hapjes dhe ecurisë së këtij programi. Fakulteti ka tre departamente. Stafi është në përputhje me Ligjin. Vetë drejtuesit kryesorë të këtij Kolegji e mbështesin fort këtë institucion. Në perfundim të investigimit të misionit dhe objektivave të programit të studimit **GVJ është i mendimit se Programi Bachelor në Inxhinieri Industriale është në përputhje me misionin e institucionit për të përgatitur specialite të lartë të edukimit inxhinierik.** Institucioni ka bërë një studim tregu lidhur me mundësinë e punësimit të specialisteve të lartë të fushës së inxhinierise industriale. Konstatohet se është një degë e re, mjaft atraktive në tregun e punës në Europë por në Shqipëri për arsye të cilat nuk kanë të bëjnë me KUIKT, siç mund të jenë mungesa e një eksperience për përgatitjen e këtyre specialistëve në vendin tonë nga universitetet publike dhe mungesa e një industrie të zhvilluar të prodhimit të madh. Kjo degë formimi inxhinierik nuk thith shumë studentë. **Pra ne si GVJ konstatuam se ka një perceptim jo të drejtë për këtë degë nga aktorë që janë jashtë këtij institucioni.** Numri i vogël i studentëve ndër vite si dhe evidentimi i kësaj problematike edhe prej vlerësuesve në kuadër të akreditimit institucional që është zhvilluar në bashkëpunim mes ASCAL dhe QAA, e

kanë shtyrë KU "IKT" që të shikojë mundësinë e ndryshimit të emrit të këtij programi si dhe përmbajtjes për ta përshtatur atë me nevojat e tregut dhe me programe të përafërta me të. GVJ sygjeroi që kjo degë pas akreditimit të mund të orientohet drejt programeve të studimit të fushave inxhinierike që janë më atraktive në tregun e punës në Shqipëri siç është inxhinieria industriale, telekomunikacionit ose në drejtim të degëve të tjera që kanë përparësi si nga pikëpamja perspektive ashtu dhe aktuale në drejtim të plotësimit të nevojave të vendit me specialistë të aftë. GVJ la si detyrë që ky objektivi të plotësohet nga viti akademik 2018-2019 e më pas.

Në përfundim GVJ thekson se Programi Bachelor në Inxhinieri Industriale, për periudhën 2012-2018, pavarësisht numrit të ulët të studentëve, ka funksionuar normalisht bazuar mbi misionin dhe vizionin e institucionit dhe objektivat për të sjellë në fushën e edukimit programe unike.

GVJ gjen se standardet e këtij kapitulli përmbushen plotësisht.

2. Struktura akademike e Fakultetit (Departamentit përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti i inxhinierisë, Departamenti i Inxhinierisë industriale. KU "Instituti Kanadez i Teknologjisë" është i organizuar në dy fakultete:

- Fakulteti i Inxhinierisë
- Fakulteti i Ekonomisë

Fakulteti i Inxhinierisë përbëhet nga këto njësi:

- Departamenti i Inxhinierisë Softuerike
- Departamenti i Inxhinierisë Industriale
- Njësia e Kërkimit Shkencor "CIRD Inxhinieri"

Fakulteti i Ekonomisë përbëhet nga këto njësi:

- Departamenti i Administrimit të Biznesit
- Departamenti i Administrimit të Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit
- Njësia e Kërkimit Shkencor "CIRD Ekonomi".

GVJ ka parë me kujdes Statutin Institucionit, Rregulloren Institucionale dhe "Librin e rregulloreve të institucionit" ku përcaktohen detyrat, funksionet, përgjegjësitë dhe procesin e vendimmarrjes.

Të gjitha departamentet përbëhen nga të paktën 7 akademikë të punësuar me kohë të plotë, prej të cilëve të paktën tre kanë gradë ose titull. (Shiko Anekse, Tabela 1)

KU "IKT" ofron programe studimi të organizuara në dy fakultete, secila në njësinë përkatëse (departamente dhe njësi kërkimore). Programet e studimeve organizohen sipas sistemit 3 + 2 të Kartës së Bolonjës. Programet e studimeve të ciklit të parë (Bachelor) zgjasin 3 vite, ndërsa ato të ciklit të dytë (Master i Shkencave) zgjasin dy vjet.

Stafi akademik gëzonte liri akademike në mësimdhënie dhe në kërkimin shkencor e sanksionuar kjo në nenin 2 të Statutit:

- a) për të organizuar veprimtaritë e mësimdhënies, ato të kërkimit shkencor si edhe veprimtaritë krijuese;
- b) për të hartuar dhe zhvilluar programet e studimit dhe për të përcaktuar fushat e kërkimit shkencor;
- c) për të organizuar procesin e promovimit të personelit akademik.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Struktura akademike e Fakultetit

Lidhur me strukturën akademike dhe organizative të Fakultetit, GVJ beri krahasimin me raportin e GVB duke kontaktuar pothuajse të gjithë personelin akademik të brendshëm dhe të jashtëm që jep mësim në këtë program studimi dhe konstatoj se nuk kishte asnjë devijim nga gjendja reale. (Shiko Anekse, Tabela 2)

- Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

GVJ, mbështetur në dokumentacionin përkatës konstaton se Stafin akademik i brendshëm kishte formimin, gradat dhe titujt si me poshtë : 8 pedagogë janë me gradën Dr ; 3 me gradën Prof. ; 11 me master. Formimi bazë i tyre është: 1 me formim Kimist; 1 me formim Bioteknologji; 12 me formim Informatike/Computer science /Computer Engineering/Telekomunikacion;1 me formim Fizike ;1 me formim Agrobiznes; 2 me formim Inxh.Elektrike;1 me formim Mekatronikë;1 me formim Gjeologji Miniera;1 me formim Inxh. Fizike; 1 me formim Matematike. GVJ konstatoi se tabela me të dhënat e stafit në raportin e GVB është e saktë dhe i përgjigjet strukturës aktuale të Fakultetit.

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Mbështetur në termat e referencës por edhe treguesve të matshëm për këtë rubrikë, si dhe mbështetur në kontrollin e dokumentacionit, GVJ konstaton se: Rezulton se Fakulteti i Inxhinierisë ka një staf prej 26 persona, nga të cilët 2 janë staf administrativ, 3 janë staf me kohë të pjesshme dhe 21 janë staf akademik me kohë të plotë. Këto të dhëna përputhen edhe me të dhënat e paraqitura në RVB. Departamenti i Inxhinierisë Industriale ka një staf prej 8 personash, nga të cilët 7 PAE (2 me tituj Prof. Dr, 1 PhD dhe 3 MSc.), dhe 1 PAK (MSc). Në ciklin e parë (Bachelor) të Inxhinierisë Industriale studiojnë aktualisht 17 studentë. Raporti i studentëve me personelin akademik të Departamentit të Inxhinierisë Industriale (PAE+PAK) është 17/8 (2.1) ose përafërsisht 1 pedagog për 2 studentë. Raporti PAE/PAK për departamentin e Inxhinierisë Industriale është 7/1 (7 PAE për PAK). Pra, PAK përfaqëson vetëm 13% të personelit akademik të këtij departamenti. Nga kontrolli i bërë nga grupi i vlerësimit të jashtëm rezulton se këto të dhëna janë të sakta.

Personeli akademik dhe drejtuesit akademikë të këtij departamenti kryejnë veprimtari të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, shërbime për zhvillimin dhe sigurimin e cilësisë në IKT, këshillim për studentët, dhënie e ndihmës për studentët (tutorial) si dhe detyra administrative në funksion të mësimdhënies. Për këtë Departament ngarkesa mësimore për personelin akademik varion përafërsisht 240 orë deri në 300 orë. Aktivitetet në të cilat merr pjesë stafi mësimor janë pjesë e kontratës së punësimit të tyre, ato janë mbështetur në Udhëzimet e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe janë rregulluar në bazë të "Librit të Rregulloreve të Instituti Kanadez të Teknologjisë.

Në kontratën e punësimit gjetëm të gjitha detyrat që duhet të realizojë stafi akademik me kohë të plotë dhe ai me kohë të pjesëshme. Ne, në cilesinë e Grupit të vlerësimit të jashtëm kontrolluam disa kontrata punësimi dhe i gjetëm ato në përputhje me raportin e GVB. Gjatë vizitës në zyrën e Burimeve njerëzore na u përshkrua hollësisht nga Drejtuesja e kësaj zyre se: Vlerësimi i performancës së stafit akademik është periodik dhe

realizohet në bazë të procedurave të saktësuar në Librin e Rregulloreve të Funkcionimit të “Instituti Kanadez i Teknologjisë” (IKT). Ky vlerësim koordinohet nga Zyra e Dekanit, NJSBC si dhe Zyra e Burimeve Njerëzore. Vlerësimi i performancës fillimisht kryhet me vetdeklarim ose vetëvlerësim nga personeli. Raporti i vetvlerësimit personal i dorëzohet Përgjegjësit të Departamentit. Më pas kryhet vlerësimi i deklaramëve të pedagogut sipas rubrikave të cilave ai i është përgjigjur. Nëse shihet e arsyeshme për të pasur një panoramë dhe më të gjerë vlerësuese, me Urdhër të Rektorit mund të ngrihet një Komision për Vlerësimin e Performancës së personelit akademik. Komisioni, si rregull, kryesohet nga Rektori dhe ka në përbërje Kryetarin e NJSBC, Dekanin e Fakultetit, Drejtuesin e Zyrës së Burimeve Njerëzore, si edhe ekspertë të jashtëm (nëse shihet e arsyeshme). Komisioni mund të intervistojë në mënyrë individuale pedagogun e brendshëm ose të jashtëm të IKT-së në lidhje me kryerjen nga pedagogu e të gjitha detyrimeve kontraktuale në cilësinë dhe sasinë e duhur ose mund të zhvillojë vizita edhe gjatë një ore mësimi. Në përfundim të procesit të vlerësimit Komisioni harton Raportin e Vlerësimit të Performancës së personelit akademik, një kopje e të cilit depozitohet në Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe NJSBC. Raporti i i Vlerësimit të Performancës së personelit akademik përdoret si bazë për zhvillimin e marrëdhënieve të punësimit ndërmjet IKT-së dhe personelit akademik të brendshëm e të jashtëm të tij, si në drejtim të kohëzgjatjes së marrëdhënies së punësimit, ashtu edhe të shpërblimit. Rezultatet e vlerësimit janë transparente, personale dhe të dokumentuara. Ato janë pjesë e dosjes së çdo pedagogu. Rezultatet e vlerësimit të brendshëm janë pjesë e analizës vjetore të punës dhe treguesve të cilësisë së departamentit. Këta tregues janë baza e vlerësimit të nevojave që ka departamenti për përmirësimin e kapaciteteve njerëzore si për trainime dhe kualifikime ashtu edhe për rekrutimin e personelit të ri akademik apo mbështetës. Po sipas drejtueses së Zyrës së Burimeve njerëzore: Propozimet për përmirësimin e kapaciteteve njerëzore (trainime/rekrutime) propozohen nga departamenti në dekanat e më pas në rektorat. Per rekrutimin e stafit akademik veprohet sipas kesaj procedure: Kërkesa më vjen nga Departamenti dhe nga Fakulteti. Zyra e rekrutimit bën shpalljen e vendit të punës në faqen eeb të institucionit. Mbledh kërkesat që vijnë për këtë vend pune. Pasi bëhet seleksionimi i dosjeve duke përjashtuar ato që nuk plotësojnë kriteret e afishuara, ngrejnë komisionin ad hoc për vlerësimin e dosjeve të mbetura. Mënyra e vlerësimit bëhet me pikë nga çdo anëtar i komisionit. Burimet njerëzore drejtojnë intervistën. Pas intervistës organizojnë oraret e pritjes së kandidatëve. Bëhet renditja dhe shpallet fituesi të cilin e njoftojmë. Personit të përzgjedhur I japin cek listën e dokumentave. Para se të fillojë të japë mësim, pedagogu duhet të plotësojë të gjitha dokumentet dhe pas plotësimit të dokumentave nënshkruhet kontrata. Kriteret kryesore mbi të cilat mbështetet vlerësimi/rekrutimi i kandidaturave reflektojnë përputhshmërinë mes profilit të kërkuar dhe aftësive të manifestuara nga aplikuesi. Elementë të rëndësishëm në procesin e vlerësimit të kandidatëve vumë re si GVJ se ishin:

- a) Përvoja në mësimdhënie, me priortet vlerësohet mësimdhënia në Universitetet e huaja në gjuhën angleze;
- b) Grada shkencore PhD ose Doktor, si dhe tituj Profesor, Profesor i Asociuar, Akademik;
- c) Cilësia dhe standardet e universitetit ku është diplomuar kandidati, ku prioritet u jepet personave me grada shkencore të marrë pranë institucioneve të arsimit të lartë me kredenciale të larta;
- d) Rezultatet personale të kandidatit dhe objektivat;
- e) Aktiviteti kërkimor e botues dhe përputhshmëria e tij me profilin e ngarkesës mësimore;
- f) Gjuha angleze;
- g) Aftësitë komunikuese;
- h) Përvoja e punësimit dhe rekomandimet e punëdhënësve të mëparshëm;
- i) Paraqitja gjatë leksionit të hapur para departamentit përkatës (kur aplikohet). Përveç pedagogëve me tituj e grada, për nevoja të veçanta dhe për periudha të caktuara, në Fakultetin e Inxhinierisë mund të punësohen edhe pedagogë që nuk kanë tituj e grada, por që kanë një përvojë të gjatë e të suksesshme në profesion/industri. Punësimi i tyre bëhet për të forcuar bashkëpunimin e akademisë me biznesin si dhe për të plotësuar kërkesa

të veçanta të programit mësimor në lëndë me karakter praktik, cikle specifike leksionesh dhe seminaresh, orësh praktike, etj.

GVJ kontrolloj vërtetësinë e tabelave me të dhënat për përshkrimin e mësipërm të paraqitura në RVB dhe rezultoj se ato janë reale dhe në përputhje me gjendjen e Fakultetit për gradat, titujt dhe cilësinë e stafit; raportin PAE/PAK; treguesit sipas moshës të PAE dhe PA ; dhe të dhënat e PAK. Personeli akademik gëzon status dhe trajtim të veçantë nga Ligji i Arsimit të Lartë 80/2015 në RSH. Aspekte të trajtimit të veçantë, si dhe përfitime të tjera të personelit akademik përcaktohen nga Bordi i Administrimit, në përputhje me rregulloren e këtij të fundit.

Sipas rolit dhe veprimtarisë që kryen, personeli akademik kategorizohet sipas ligjit të arsimit të lartë në:

- a) profesorë;
- b) lektorë;
- c) asistent-lektorë,

Nivelet e pagave të kategorive të personelit akademik miratohen nga Bordi i Administrimit .

Ngarkesa mësimore vjetore e stafit akademik caktohet me vendim të Senatit Akademik .

Bazuar në "Manualin për Punonjësit e Fakultetit" (Faculty Handbook), në takimin e parë që punonjësi i sapo marrë në punë bën me Burimet Njerëzore, atij i bëhen të ditura sipas manualit të drejtat dhe detyrat e tij. Një kopje e Manualit gjendet edhe në formatin elektronik dhe në Faqen eeb të IKT (kategoria My CIT, rezervuar vetëm për stafin e institucionit). **GVJ kontrolloj eeb-in e institucionit dhe e gjeti atë në funksionim.**

Për sa më sipër shiko Anekse, tabela 3-9

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
III - PERSONELI I INSTITUCIONIT	
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>GVJ mbështetur në dokumnetacionin e paraqitur nga Institucioni por edhe gjatë vizitave në këtë institucion konstaon se: Parimet, kriteret dhe procedurat për punësimin e personelit akademik efektiv dhe me kohë të pjesshme janë të përcaktuara në dokumentacionin bazë që rregullon veprimtarinë e IKT-së. Kriteret shpallen publikisht dhe përzgjedhja bëhet me konkurim të hapur. Procesi i rekrutimit është i hapur dhe Komisioni i Rekrutimit përbëhet nga: Zv. Rektori, Drejtuesi i Zyrës së Burimeve Njerëzore, Dekani i Fakultetit, Përgjegjësi i Departamentit përkatës dhe sipas rastit pedagogë, si dhe ekspertë të fushave përkatëse. Personeli akademik me kohë të plotë, përgjegjës për ofrimin e programit të studimit "Bachelor" në Inxhinieri Industriale vlerësohet të jetë 98% e personelit akademik të angazhuar në këto program (2017-2018). Pranimet behen me konkurs dhe në mënyrë transparente si edhe në përputhje me kuadrin ligjor në RSH. Konkursët ndjekin në mënyre rigoroze dhe transparente të gjitha hapat e nevojshme. Egziston baza e të dhënave për raportet e rekrutimit të personelit si edhe mbahet në arkivë cdo dokument që ka të bëjë me rekrutimin, ecurinë dhe kualifikimin e stafit akademik.</p>
Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.	

<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor,, ose titullin akademik “Docent,,.</p>	<p>Në zyrën e personel rekrutimit në cilësinë e GVJ gjetëm bazën e të dhënave për cdo anëtar të stafit akademik si edhe të dhënat e personit përgjegjës për organizimin e programit mësimor që është përgjegjësi i departamentit. Institucioni dispononte listën e plotë si të personelit akademik ashtu edhe atij ndihmës administrative. Titullaret e lëndëve mbanin gradën Doctor. Shumë prej tyre kanë mbaruar studimet në Universitete perëndimore të dëgjuara dhe njohura ndërkombëtarisht. Ka gjithashtu titullarë të lëndëve që janë pedagogë të huaj me grada shkencore, të cilët punojnë pranë KU “IKT” Lista e stafit me kohë të pjesshme aprovohet në senat, sipas propozimeve të fakulteteve përkatëse çdo vit akademik. Ndërkohë që përsa i përket rekrutimeve të reja, kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik dhe ndihmës publikohen në Ëebsite-n e IKT ose dhe diku tjetër, për një periudhë minimalisht dy-javore.</p>
<p>Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).</p>	<p>IKT ka në përbërjen e vet një staf ndihmës mësimor të konsiderueshme si për përmbushjen e detyrave administrative por edhe laboratorike si edhe për kujdesin ndaj studentëve etj. GVJ konstatoi se grupi ndihmës i IT ishte në dispozicion të studentëve gjatë gjithë kohës së zhvillimit të procesit mësimor, laboratorik por edhe gjatë realizimit të diplomave si punime të pavarura të studentëve. Personeli akademik është i kualifikuar dhe i shërben një numri të vogël studentësh (mbi bazë PAE të departamentit përkatës 7/17 studente, ose 1 pedagog 2.4 studentë) dhe ky raport siguron përkushtim dhe dedikim ndaj studentëve. Ngarkesa mësimore e pedagogëve me një mesatare prej 220-240 orë për vit akademik dhe maksimalisht 300 orë për vit akademik bën të mundur një përkushtim të konsiderueshëm ndaj studentëve, cilësi dhe optimizim të burimeve.</p> <p>Në IKT për zhvillimin e rregullt dhe cilësor të praktikave profesionale, institucioni ka krijuar Zyrën e Shërbimit të Studentëve (Student Affairs Office), e cila ka si qëllim parapërgatitjen e studentëve për procesin e praktikave profesionale dhe dhënie të informacionit dhe asistencës së nevojshme studentëve për gjetjen e mundësive për kryerjen e praktikave profesionale/stazheve/internshipeve të ofruara nga institucione partnere e më gjerë. Në përgjithësi shfrytëzohen marrëveshjet institucionale që IKT ka si institucion me institucionet e tjera. Muaji Maj është koha e zhvillimit të praktikës profesionale. Shumica e studentëve interesohen duke shfrytëzuar njohjet personale për zhvillimin e praktikës. Për studentët që nuk kanë kontakte të tilla, i vjen në ndihmë institucioni me marrëveshjet që ka. Në fund të mbarimit të praktikës plotësohet një formular nga mbikëqyrsi por edhe nga ambjenti ku zhvillohet praktika. Krahas rolit të kësaj zyre, studentëve u caktohet një pedagog mbikëqyrës, i cili ndjek zhvillimin korrekt të praktikës mësimore në institucionin pritës. Vlerësimi i studentëve për praktikën profesionale bëhet nga një komision vlerësues i cili ngrihet nga Këshilli i Fakultetit. Komisioni përbëhet nga pedagogu</p>

	<p>që e ka mbikëqyrur studentin gjatë praktikës, përgjegjësi i departamentit, dhe një ose dy pedagogë të tjerë nga Departamenti. Egzistonin kontratat tip dhe reale midis IKT dhe enteve publike dhe private ku studenti nën mbikëqyrjen e profesorit realizonte praktikën mësimore. Disa nga këto kontratat do ti gjeni në shtojcën e këtij dokumenti të cilat GVJ i bashkëngjiti. Ndërkohe aty do të gjeni edhe shumë komunikime elektronike ndërmjet institucionit dhe kompanive të ndryshme private dhe enteve publike për mundësi punësimi të studentëve</p>
<p>Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtijshëm të personelit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtijshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.</p>	<p>IKT ndjek me vemendje të posaçme kualifikimin e vazhduar të stafit të vet. Kjo u konstatua jo vetëm me pjesëmarrjen e tyre në Konferenca Ndërkombëtare por edhe Kombëtare duke i mbështetur ata financiarisht ku pedagogu i IKT-së është referues, sipas rregullores institucionale. Ndërkohë një pedagogje efektive e departamentit përkatës ka qënë për kualifikim jashtë shteti në kuader të programit CEPUS Gjithashtu, institucioni mbështet kualifikimin e pedagogëve pa gradë për të ndjekur studimet e doktoraturës në institucione brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Një sërë trajnimesh janë zhvilluar prej institucionit për të mbështetur e ndihmuar pedagogët e rinj, si dhe për të trajtuar problematika të ndryshme në favor të përmirësimit të cilësisë në fushën e edukimit.</p>
<p><u>Konkluzione të GVJ:</u></p>	
<p>Nga kontrolli rezulton se Fakulteti i Inxhinierisë ka një staf prej 26 persona, nga të cilët 2 janë staf administrativ, 3 janë staf me kohë të pjesshme dhe 21 janë staf akademik me kohë të plotë. Keto të dhena perputhen me Tab.2 ne RVB. Departamenti i Inxhinierise Industriale ka një staf prej 8 personash, nga të cilët 7 PAE (2 me tituj Prof. Dr., 1 PhD, dhe 3 MSc.), dhe 1 PAK (MSc). Në ciklin e parë (bachelor) të inxhinierisë industriale studiojnë aktualisht 17 studentë. Raporti studentëve me personelin akademik të Departamentit të Inxhinierisë Industriale (PAE+PAK) është 17/8 (2.1) ose përafërsisht 1 pedagog për 2 studentë. Raporti PAE/PAK për departamentin e Inxhinierisë Industriale është 7/1 (7 PAE për PAK). Pra, PAK përfaqëson vetëm 13% të personelit akademik të këtij departamenti. Nga kontrolli i bërë nga grupi i vlerësimit të jashtëm rezulton se këto të dhëna janë të sakta.</p> <p>Personeli akademik dhe drejtuesit akademikë të këtij departamenti kryejnë veprimtari të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, shërbime për zhvillimin dhe sigurimin e cilësisë në IKT, këshillim për studentët, dhënie e ndihmës për studentët (tutorial) si dhe detyra administrative në funksion të mësimdhënies. Për këtë departament ngarkesa mësimore për personelin akademik varion përafërsisht 240 orë deri në 300 orë. Ne, në cilësinë e Grupit të vlerësimit të jashtëm kontrolloam disa kontratat punësimi dhe i gjetem ato të rregullta. Vlerësimi i performancës së stafit akademik është periodik dhe realizohet në bazë të procedurave të saktësuar në Librin e Rregulloreve të Funkcionimit të “Instituti Kanadez i Teknologjisë” (IKT). Rezultatet e vlerësimit janë transparente, personale dhe të dokumentuara.</p> <p>Ngarkesa mësimore vjetore e stafit akademik caktohet me vendim të Senatit Akademik .</p> <p>IKT ndjek me vemendje të posaçme kualifikimin e vazhduar të stafit të vet. Në IKT për zhvillimin e rregullt dhe cilësor të praktikave profesionale, institucioni ka krijuar Zyrën e Shërbimit të Studentëve (Student Affaires Office)</p>	

4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residenat.

Mjediset

Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë", ndodhet pranë Sheshit Eëllson në qendrën ZAJED. Pozicioni i tij i vendosjes është afër shërbimeve dhe institucioneve të ndryshme publike dhe private, arsimore dhe me gjerë, të cilat bëjnë që të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët, që në këtë mënyrë kursejnë kohë. Për qëllime shpłodhje dhe argëtimi studentët kanë në dispozicion një sipërfaqe prej 175m² (njëqind e shtatëdhjetë e pesë metra katrorë). U vërejtën nga GVJ edhe sallat e leksioneve, sallat e pedagogëve, ambjentet clodhëse, labororët, biblioteka. Kolegji Universitar «IKT», ofron për studentët dhe personelin ambientet e palestrës (Fitness Room-it), e cila ofron mundësi për zhvillimin e aktiviteteve sportive, në oraret e zgjedhura nga vetë studentët dhe personeli. Gjithashtu IKT, për studentët dhe stafin akademik ka edhe bar restorantin, i cili ofron me zbritje çmimi të gjitha shërbimet. Studentët në IKT, kanë një jetë aktive sociale dhe kulturore.

Gjatë vizitës në Institucion na u komunikua se janë krijuar nga studentët disa klube shkencore, social-kulturore, sportive etj, të cilët në mënyrë të vazhdueshme zhvillojnë aktivitete brenda dhe jashtë IKT. Çdo vit IKT ka financuar dhe mbështetur studentët në udhëtime turistike-kulturore, duke ofruar dhe nxitur në këtë mënyrë një klimë të ngrohtë bashkëpunimi midis studentëve dhe stafit akademik. Të gjitha aktivitetet e studentëve janë pasqyruar gjerësisht në Katalogun e veprimtarive të IKT, një kopje e të cilit gjendet në shtojcë. Po ashtu të gjitha aktivitetet e zhvilluara brenda dhe jashtë institucionit nga studentët apo nga stafi akademik janë publikuar edhe në faqen e internetit të KU "IKT". Studentët kanë mundësi të përfitojnë nga përmirësimi i laboratorëve në çdo kohë.

KU "IKT" i ka kushtuar një rëndësi specifike mjediseve, për t'i dhënë mundësi stafit akademik, atij administrative si dhe studentëve që të gjëjnë hapësira të konisderueshme për aktivitetet, studim dhe shpłodhje. Të gjitha mjediset ofrojnë infrastrukturën e nevojshme, me dritë, sistem ngrohje dhe ftohje, ndriçim, ujë, ëireless, bibliotekë për të lexuar apo studiuar si dhe labororë ku stafi e studentët të kenë mundësi për të përparuar në detyrat e tyre dhe për të pasuruar njohuritë.

Për sa më sipër referencë RVB por edhe vizita në institucion

Infrastruktura.

Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë ofron një sipërfaqe prej 2722 m² (dymijë e shtatëqintë metra katrorë), të shpërndara në 8 kate. Nga këto 867.5 m² klasa dhe laboratore; 1775.3 m² mjedise për Fakultetin e Inxhinierisë përgjegjëse për zhvillimin e programit mësimor; norma është 5.5 m², e cila është mëse e tejkalueshme; 374,1 m² mjedise për stafin me 14,8 m²/staf me një normë dukshëm të tejkalueshme. Nga kontrolli që ushtuam konfirmojmë vërtetësinë e të dehnave mbi madhësinë e siperfaqeve të kateve dhe hapësirave të shfrytëzueshme, klasave dhe laboratorëve dhe të hapësirave të shfrytëzueshme nga stafi akademik. Mjediset e sallave të mësimi, laboratorëve, zyrat dhe shërbime të tjera, janë të një standarti të lartë dhe të pajisura me të gjithë infrastrukturën e nevojshme jo vetëm për zhvillimin komod dhe me standarte të procesit mësimor, por edhe me facilitete dhe përfitime si për studentët ashtu edhe për stafin akademik. Në shfrytëzim nga Institucioni është edhe kati -1, ku është e vendosur palestra (Fitness Room), e cila është e shfrytëzueshme si nga studentët ashtu edhe nga stafi. Për zhvillimin e procesit mësimor janë në dispozicion 6 salla mësimi dhe 6 labororë, prej të cilëve 4 labororë kompjuterike, 1 laborator Fizike/Sistemet e qarqeve dhe 1 laborator Kimie i cili shfrytëzohet për praktika profesionale dhe lëndore. Të gjitha sallat dhe labororët

janë të pajisur me projektorë, tabelë shënimesh dhe kanë ajër të kondicionuar. Procesi mësimor zhvillohet në kushte shumë të përshtatshme të parametrave fizike (temperatura, ndriçimi, lagështira, drita etj)

Me të njëjtën cilësi të parametrave fizikë, si dhe me një sipërfaqe të konsiderueshme ofrohen ambientet e zyrave për stafin drejtues administrativ dhe atë akademik

Gjithashtu IKT ka ofruar dhe një sipërfaqe parkimi prej 530 m² në të cilën mund të parkojnë 40-50 autovetura.

Për qëllime të organizmit të aktiviteteve shkencore, (konferenca, seminare, leksione të hapura, tryeza të rrumbullakëta etj), sociale, kulturore, institucioni, fakultetet dhe departamentet, shfrytëzojnë sallën e konferencave e cila ka një sipërfaqe prej 78.5 m², me kapacitet 70 persona.

Për sa më sipër referencë RVB por edhe vizita në institucion

Biblioteka e Kolegjit Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë".

Biblioteka ndodhet në katin e katërt dhe ka një sipërfaqe prej 60 metra katrorë. Qëllimi i Bibliotekës së IKT është të sigurojë studentët dhe personelin akademik me burimet dhe mjedisin e studimit që kanë nevojë dhe për të mbështetur studentët në gjetjen e literaturës, revistave apo titujve të librave që ata kërkojnë.

Për më tepër, biblioteka e IKT kujdeset për një jetë më të mirë komunitare dhe është e hapur për publikun. Biblioteka e IKT ka një kapacitet prej 28 vendesh ku 6 vende janë për përdorim kompjuteri (elektronik). Dhoma e leximit është projektuar për studentët që të kenë mundësinë të studiojnë dhe të bëjnë kërkime. Biblioteka e IKT ka filluar funksionimin e saj në prill të vitit 2011. Shërbimi i bibliotekës kryhet nga përgjegjësja e Bibliotekës, që ofron shërbimet e saj për studentët, stafin akademik dhe komunitetin. Ne morëm kontakte direkt me punonjësen e bibliotekës dhe konfirmuam vërtetësinë e raportit të vlerësimit të brendshëm lidhur me numurin e titujve, shfrytëzimit të fondeve të cilat ishin të hapur si për stafin akademik dhe për studentët. **Mendojmë se biblioteka duhet të jetë e hapur edhe për stafet akademike të Universiteteve të tjera publike ose jo dhe jo vetëm në sallat e saj por edhe për shfrytëzim literature jashtë këtyre sallave. Kjo do të rritë bashkëpunimin e IKT me institucionet homologe në vend.**

Duke u përballur me faktin se gjuha angleze është gjuha e përdorur brenda IKT, fillimisht biblioteka ka ndërtuar koleksionin e saj nga 20.000 tituj të ardhur nga USA.

Gjenden rreth 250 tituj në IKT lidhur vetëm me Inxhinierinë, dhe 347 tituj në Teknologjinë e Informacionit. Ndërkohë që në Bibliotekën Virtuale ka rreth 60 tituj që i ofrohen studentëve në fushën e inxhinierisë.

Titujt e mbetur nga 20.000 titujt që erdhën nga SHBA, u dhuruan institucioneve të tjera në nevojë të tilla si: *Shkolla të mesme; fondacione studentore; dhe Akademise së Arteve, Tiranë.*

Në lidhje me investimet që janë bërë drejt bibliotekës së IKT, që nga viti 2012 është investuar në tituj të përditësuar në fushën e Inxhinierisë dhe Ekonomisë, duke bashkëpunuar drejtpërdrejtë me:

1) Cengage Learning,

2) Amazon dhe

3) Educational Center Albania.

Ndërkohë, gjatë viteve, janë bërë investime të vazhdueshme në prurjen e titujve të rinj e abonimeve në revista si: *IEEE Spectrum, Optics & Photonics, Spie Professional and Physics Today*, këto për Fakultetin e Inxhinierisë. Një kontribut shumë i rëndësishëm është dhënë nga Rektori i IKT, Prof. H. Hamam duke ndarë me ne abonimet ndërkombëtare që janë të pamundura të arriheshin nga Shqipëria, për shkak të shërbimit të ngadaltë postar, ose dhe sigurisë së shërbimit.

Për më tepër, janë bërë investime të vazhdueshme për të fituar akses në burime të ndryshme elektronike, të lidhura me fushat e Inxhinierisë dhe Ekonomisë si:

Projekti ERA 2012 që siguron qasje në bazat e të dhënave si:

- Multi-Science Journals Collection
- Ebrary academic complete
- EBSCO academic search premier
- Emerald management eJournals Collection
- ProQuest Central
- Taylor & Francis Library

Me rritjen e numrin të studentëve në të dy fakultetet e IKT, në vitin 2014 Biblioteka e Institutit Kanadez të Teknologjisë, firmosi një abonim në burimet elektronike **EBSCO**, që është një nga liderat e tregut të ofruesve të bazave të të dhënave kërkimore, e-revista, ebooks dhe shërbime akademike.

Kështu, që nga viti 2016 deri më sot, IKT ka kapitalizuar krijimin e **Bibliotekës Virtuale** të IKT-it. Kjo është arritur në bashkëpunim me **McGraë-Hill Education**, bazuar në marrëveshjen e nënshkruar midis dy palëve.

Aktualisht, Biblioteka e IKT ka një fond të pasur me rreth 3000 tituj. Kryesisht në fushat e lidhura me IT dhe Inxhinierinë Softuerike, Biznesin, Menaxhimin, Inxhinierinë Industriale, Metodologji Anglishteje, Letërsi Angleze, Arte etj.

Për më tepër, IKT ka 200 tituj të rinj dhe koherent në formatin elektronik dhe print. Ndërsa rreth 40% e tyre janë për Fakultetin e Inxhinierisë Softuerike dhe Industriale, pjesa tjetër i përkasin fushës së Biznesit dhe Ekonomisë. Për çdo titull elektronik, Biblioteka e IKT, ka një kopje të shypur të librit dhe studentët kanë akses në të dy format e leximit.

Gjithashtu, në faqen e internetit të Bibliotekës, janë vendosur në dispozicion të studentëve, database të hapura, baza të dhënash akademike falas, libra të hapur, revista falas, baza të dhënash kërkimore, si dhe kurse të hapura online të ndjekura në universitete shumë të njohura në mbarë botën. Për më shumë informacion, ju mund të konsultoni faqen e internetit të IKT, seksionin e bibliotekës.

Lidhur me blerjet e teksteve shkollore, nevojat e Fakultetit i bëhen të njohura bibliotekës me anë të listë kërkesave në print apo formë dixhitale, të paraqitura nga fakulteti në Bibliotekë. Kjo procedure bëhet, 1-2 herë por dhe më shumë herë gjatë vitit nga Biblioteka, duke i dërguar një formë elektronike/ print "Kërkesë për blerje" drejt Dekanëve dhe Shefave të Departamentit dhe stafit akademik. Kjo formë më pas i kthehet e plotësuar Bibliotekës dhe pasi bëhen verifikimet e duhura nis procesi i porosisë së librave. Paraqitja e hershme e kërkesës është e rëndësishme për të siguruar që materialet të jenë në dispozicion për fillimin e vitit akademik apo simestrit.

Përveç kësaj, biblioteka kërkon rregullisht bashkëpunimin e anëtarëve akademikë, duke ndarë informacion në lidhje me abonime të mundëshme në baza të ndryshme të dhënash.

Të gjitha kërkesat maten në një sërë kriteresh për të siguruar mbulim të barabartë në të gjitha fushat e lëndëve.

Biblioteka mbetet e hapur gjatë gjithë kohës së orareve të reklamuar. Studentët dhe stafi mund të kenë akses 24 orë në internet në databasin e Bibliotekës dhe në Bibliotekën Virtuale, përmes faqes së internetit të IKT.

Shërbimet që u ofrohen studentëve

Drejtimesja e Bibliotekës, ishte e përkushtuar për të ndihmuar dhe këshilluar studentët dhe anëtarët e stafit në gjetjen e librave dhe burimeve të tjera të nevojshme për studentët dhe stafin mësimdhënës.



Materialet e bibliotekës mund të përdoren në mjedisin e bibliotekës ose mund të huazohen për përdorim të jashtëm, duke ndjekur rregulloret e huazimit të bibliotekës. Siç u përmend më lart, gjatë vitit akademik 2016 u shtua një shërbim shtesë studentëve dhe anëtarëve të stafit akademik. Krijimi i Bibliotekës Virtuale të IKT, e cila siguron qasje në stafin akademik dhe studentët në tekstet shkollore. Ky akses krijohet sipas marrveshjes që IKT ka firmosur me shtëpinë botuese McGraë-Hill Education, Angli. Database i bibliotekës KOHA dhe Biblioteka Virtuale mund të konsultohen nga faqja e internetit e bibliotekës së IKT, ndërsa i gjithë stafi dhe student e IKT mund të kenë qasje në burimet e tyre elektronike në çdo kohë.

Akresi në Bibliotekë

Biblioteka është e hapur gjatë gjithë ditës për të gjithë studentët e stafin akademik. Studentët dhe stafi mund të shfletojnë materialet e bibliotekës në një ambient komod e të ngrohtë të pajisur me të gjithë infrastrukturën e nevojshme për frekuentuesit. Biblioteka IKT është një bibliotekë me "**fond të hapur**", që do të thotë se studenti është në gjendje të kërkojë, të zgjedhë dhe të gjejë vetë librat në vend që të depozitojë një kërkesë për libra drejtë Menaxherit të Bibliotekës.

Megjithatë, koncepti i "**përdorimit të bibliotekës**" nuk është i kufizuar në konsultimin e literaturës. Studentët përdorin bibliotekën për të pasur akses në kompjuterë, internet, revista dhe thjesht bëjnë pyetje dhe kërkojnë këshilla nga punonjësja e bibliotekës në lidhje me hulumtimet, stilet e ndryshme të shkrimit dhe çështjet teknike që kanë të bëjnë librat elektronik. Por frekuentimi i bibliotekës, bëhet dhe thjesht për tu takuar me grupin e studimit.

Aktivitete në Bibliotekë

Që nga hapja e bibliotekës deri më sot, shumë aktivitete ishin organizuar brenda bibliotekës gjatë viteve. Zhvillohen takime me studentet; ëorkshope si edhe evente sociale dhe kulturore si muaji i poezisë; nata e filmit, takimi i klubit të librit, mbledhje të klubit të bamirësisë, si dhe takime të tjera ndërmjet instruktorëve dhe studentëve.

Biblioteka e IKT është një pikë takimi midis studentëve të të gjitha niveleve (bachelor dhe master) dhe një hapësire ideale për studentët për të zhvilluar idetë dhe aktivitetet shoqërore.

Për sa më sipër referencë RVB por edhe vizita në Bibliotekën e institucionit

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit

- Salla për leksione – 4
- Klasa për seminare - 4
- Salla për aktivitete promovuese - 1
- Salla për praktikë lëndore/ profesionale -1
- Laboratorë për lëndët - 4
- Laboratorë informatike - 2
- Salla interneti - 2
- Salla për bibliotekë - 1
- Mjedis për fotokopjime, librari etj - 1
- Zyrë informacioni për studentët - 5
- Nyje hidrosanitare - 9


Mjediset për stafin:

- Mjedise për Dekanin/ kancelarin
- Zyra për sekretarinë mësimore
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore
- Zyra për personelin akademik

Të dhënat për mjediset për stafin gjenden në anekse Tabela 10

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<p align="center">V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI</p>	
<p>Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në Institucion konstaton se Biblioteka ka rreth 3000 tituj gjithsej, me 20 tituj në gjuhën shqipe dhe rreth 2980 tituj në anglisht, dhe me një sektor të veçantë të gjuhës së huaj, si frëngjisht, spanjisht, gjermanisht, italisht. Të gjithë titujt e bibliotekës përditësohen rregullisht në databasin e Bibliotekës. Biblioteka e IKT ka Bibliotekën e saj Virtuale, e cila është krijuar dhe përshtatur e bazuar në nevojat e IKT. Të gjitha librat elektronikë që ekzistojnë në bibliotekën virtuale të IKT, janë nga bashkëpunimi me McGraë-Hill Education, një nga tre botuesit akademikë më të njohur botërorë. Po ashtu literatura e vënë në dispozicion prej marrëveshjes me McGraë-Hill Education shërben edhe për tekstet mësimore të të dy fakulteteve. Një nga qëllimet kryesore të bibliotekës është që të ketë literaturën e duhur dhe në kohën e duhur për studentët dhe stafin. Për këtë arsye dhe për një proces sa më të suksesshëm akademik, në fund të vitit akademik, biblioteka dërgon një formular dixhital "Formular për kërkesë librash" për të gjithë personelin akademik, dekanët dhe përgjegjësit e departamentit. Pas krijimit të listës së materialeve akademike të kërkuar nga instruktorët, biblioteka fillon blerjet ndërkombëtare, duke u siguruar që të gjitha titujt e duhur do të jenë në kohën e duhur në institucion për stafin akademik si dhe për studentët. Nisur nga çka është sqaruar në detaje më lart, dy herë në vit biblioteka investon me tituj të rinj në fushat e studimit që kanë lidhje me të 2 fakultetet e IKT. Lidhur me periodikët, përditësime të rregullta bëhen në revista periodike të disponueshme në bibliotekën IKT. Periodikët përfshijnë abonime në revista si: IEEE Spectrum, Optika & Fotonika, Spie Professional dhe Physics Today për Fakultetin e Inxhinierisë dhe 2 periodika të tjera në fushën e Ekonomisë. Kopjet e këtyre periodikëve gjenden të aksesueshëm në bibliotekë. Oraret e Bibliotekës, janë përshtatur me nevojat e studentëve. Biblioteka qëndron e hapur për studentët dhe stafin gjatë gjithë javës dhe ofron shërbim edhe për komunitetin pranë institucionit, duke ofruar akses të hapur për titujt e saj. Studentët dhe stafi mund të kenë akses 24 orë në internet në Bibliotekën Kërkimore (Databasi i Bibliotekës) përmes faqes së internetit të Bibliotekës IKT. Biblioteka e IKT vendos në dispozicion të stafit dhe studentëve dhe 6 kompjutera të pajisur me të gjitha programet që këta kompjutera mbajnë dhe në klasat apo laboratorët e studimit.</p>




Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.

- Kriteri 1** Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;
- Kriteri 2** Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;
- Kriteri 3** Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;
- Kriteri 4** Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.
- Kriteri 5** Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, linguistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programstimulimi për shkencat sociale etj.
- Kriteri 6** Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.

Nga vezhgimet e kryera nga ne në cilesine e GVJ, Kolegji Universitar "IKT", dëshmon se, nisur edhe nga numri i studentëve, ka në sasi të mjaftueshme të laboratorëve, klasave, zyrave, studiove dhe mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit për realizimin e programit të studimit. Praktikisht IKT disponon 6 laboratorë (4 laboratorë me rreth 100 kompjutera, një laborator Fizike/Sistemet e Qarqeve i pajisur me 2 kompjutera dhe pajise të tjera shtese) që janë të kompletuar për të mbështetur zhvillimin e mësimin në mënyrë të plotë me të gjithë softuerët e nevojshëm dhe një laborator kimie i pajisur me pajisjet dhe mjetet e nevojshme për zhvillimin e orëve laboratorike. Kjo është e ndihmuar edhe nga fakti, se mësimi në Kolegjin Universitar "IKT", zhvillohet gjatë gjithë ditës, nga ora 09.00-21.00. Alternimi i orarit sipas ciklit të studimeve, por edhe programeve e rrit edhe më tepër mundësinë e shfrytëzimit të klasave, laboratorëve, zyrave dhe mjediseve të tjera. Mjediset mësimore të Kolegjit Universitar "IKT", janë të përshtatshme për mësimdhënie, dhe plotësojnë kërkesat e programit. Klasat janë të pajisura me mjetet e nevojshme teknologjike, duke filluar nga kompiuterat (në të cilat janë të instaluar të gjitha softet që kërkon programi i studimit), projektorë, tabela shënimesh etj. Në shërbim të studentëve janë dy laboratorë si ai i Fizikës dhe ai i Kimisë, si dhe institucioni ka në përdorim 4 laboratorë informatike për qëllime mësimore. Pajisja e laboratoreve me kompjutera sic është paraqitur në RVB konfirmohet nga ana jonë. Çdo student ka akses në laboratorë në çdo moment gjatë gjithë javës (e hënë – shtunë) nga ora 9:00 deri në 21:00. çdo ambient i institucionit është i mbuluar nga rrjeti Eİ-FI dhe studentët mund të aksesojnë internetin në çdo moment free. IKT, dhe njësitë e tjera si Fakulteti dhe Departamenti, i kushtojnë rëndësi teknologjisë, cilësisë së laboratorëve por edhe programeve kompjuterike të cilat shfrytëzohen për module apo lëndë të ndryshme. Shumë prej lëndë/moduleve i japin një peshë të madhe realizimit të projektit nga ana e studentit, të cilët në çdo orë të ditës mund të shfrytëzojnë laboratorët kompjuterike si dhe programet e instaluar në këto laboratorë, për realizimin e projekteve dhe detyrave të caktuara. Të gjitha programet e instaluar janë të licensuara në bazë të kontratës së përvitshme me *Microsoft Imagine Academy* ose janë free. IKT është një nga të paktët IAL që kanë blerë licencat e softëerëve që përdoren nga studentët e pedagogët. Të gjithë laboratorët janë të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin sa më modern të procesit mësimor. Instalimi, mirëmbajtja dhe azhurnimi i pajisjeve kompjuterike bëhet nga stafi i departamentit të IT.

Instalimet e programeve të reja bëhen në kohë reale në bazë të kërkesave të pedagogëve. Së fundi IKT po krijon laboratorin e Big Data, që do të jetë i pajisur me kompjuter me aftësi llogaritëse të madhe të specializuar për problemet e Big Data. Të gjitha programet kompjuterike të instaluar i përshtaten programeve mësimore nëpërmjet instalimit të aplikacioneve që kërkohen nga departamentet përkatëse. Kompjuterat kanë të instaluar një antivirus, Microsoft Security Essentials, i cili mundëson sigurimin e dokumenteve dhe të dhënave të tjera prej infektimit nga viruse të ndryshme. IKT, i kushton një rëndësi shumë të madhe realizimit të pjesës praktike të programit mësimor. Praktika profesionale e programit të studimit, është e planifikuar në vitin e III të studimit, semestri i dytë. Me qëllim që praktikat mësimore, të jenë të orientuara sa më mirë dhe drejt institucioneve që i plotësojnë kërkesat e programit të praktikës mësimore të programit të studimit, IKT ka lidhur disa marrëveshje bashkëpunimi me Institucione, kompani të cilat ofrojnë mundësinë e zhvillimit të praktikës mësimore për studentët e programit të studimit Bachelor Inxhinieri Industriale .

Konkluzione të GVJ:

Pas përfundimit të këtij kapitulli, GVJ, diskutoi dhe konstatoi se programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Industriale i përmbush kriteret e kërkuara në këtë kapitull. Të gjitha programet zhvillohen në një godinë dhe për një menaxhim efikas, zyrat e administratës janë vendosur në katin e parë ndërsa mësimdhënia dhe zyrat e personelit akademik janë të vendosura në kate të veçanta. Godina aktuale është në dispozicion të KU "IKT" dhe institucioni mund të zgjerohet në katet e tjera me shtimin e numrit të studentëve. Institucioni ka vënë në shërbim të mësimdhënies si dhe për synime të tjera sipërfaqe të konsiderueshme për të garantuar kapacitetet e nevojshme për realizimin e praktikave studimore në laboratorë, realizimin e mësimdhënies, zyra për administratën, arkivat, ambiente sportive, bar-restorant, fitness room dhe zyra për personelin akademik. Ambienti ka pozicion drite nga të gjitha drejtimet si dhe siguron ngrohje dhe ftohje për stafin dhe studentët. GVJ konstaton se ambientet për numrin aktual të studentëve janë të mjaftueshme si dhe plotësojnë kushtet e kërkuara. Institucioni ka vënë në shërbim të studentëve një bibliotekë të pasur me literaturë në gjuhë të huaj, kryesisht anglisht, të dedikuar për programet e studimit. Po ashtu një marrëveshje për sigurimin e teksteve mësimore është nënshkruar dhe me një ndër kompanitë më të njohura botërore sic është ajo e "McGraë Hill Education". Bibiloteka pasurohet rregullisht me tituj librash e periodikësh.

GVJ gjen se standardet e këtij kapitulli përmbushen plotësisht

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Burimet e financimit

Kolegji Universitar "IKT" është institucion jo publik dhe operon si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (shpk). Institucioni financohet nga:

1. Tarifat e studimit që paguhën nga ana e studentëve;
2. Financim nga ana e Ortakut, gjë për të cilën ka edhe një letër angazhimi;

3. Donacione të ndryshme që merren nga ana e IKT. IKT çdo vit kryen Audit Financiar nga ku kontrollohen të gjitha llogaritë kontabël. Kontrolli është i përqendruar nëse janë zbatuar “Standardet Kombëtare të Kontabilitetit” dhe legjislacioni në fuqi. Kapaciteti Menaxhues Financiar është i mjaftueshëm dhe kjo siguri vjen si pasojë e angazhimit të Ortakut. GVJ kontrolloi te dhenat në raportin e vleresimit të brendshëm mbi të ardhurat dhe financimi i KU “IKT” në tre vitet e fundit dhe konfirmojmë vërtetësinë e saj.

Të ardhurat dhe financimi i KU i marrë nga RVB Anekse, Tabela 11

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):

- Grantet për kërkim
- Konsulencat, shërbimet
- Tarifat për dhe gjatë shkollimit
- Sponsorizimet
- Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)
- Donacionet, aktivitetet siguroese, fondacione etj
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Nga totali i të ardhurave, C.I.T shpk në mënyrë të përgjithshme gjeneralizon për secilin program në plotëpjestim me numrin e programeve aktive, shpenzimet korrente për funksionimin e programit; procesit të mësimdhënies, pagat, shpenzime mirëmbajtje, konferenca, publikime etj.

Transparenca dhe kontrolli i brendshëm financiar, Auditimi dhe rezultatet

Pasqyrat Financiare të IKT janë transparente dhe në to ka akses çdo person të cilit mund t'i interesojnë, këto pasqyra bëhen publike çdo vit në faqen e internetit të QKB-së (Qendra kombetare e Biznesit), gjithashtu së bashku me Pasqyrat Financiare publike bëhet edhe raporti i Audituesit të pavarur. **Ne kontrolloam disa nga këto pasqyra dhe i gjetëm konform ligjit shqiptar të konatbilitetit financiar.**

Kapacitetet menaxhuese financiare

Menaxhimi i buxhetit të aprovuar nga investitori/ortaku i vetëm menaxhohet dhe administrohet nga Administratori. Institucioni në mënyrë të rregullt kontabilizon çdo veprim ekonomik-financiar sipas ligjeve në fuqi dhe i paraqet në Pasqyrat Financiare. Një draft propozim i buxhetit miratohet prej Senatit Akademik (sipas njësive të institucionit) dhe i dorëzohet administratorit .

Zyra e financës operon sipas buxhetit të miratuar dhe rregulloreve të brendshme të institucionit dhe legjislacionit në fuqi.

Një aspekt pozitiv i punës së IKT është fakti që institucioni ofron bursa studimi për kategori të ndryshme studentësh bazuar tek mesatarja apo nevojat/vështirësitë e ndryshme që paraqesin studentët sipas argumentimit përmes dokumentacionit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.	

<p>Kriteri 1 Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;</p> <p>Kriteri 2 Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratatë të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Institucioni kryen Auditim Financiar të jashtëm çdo vit, Bilanci zyrtar i përvitshëm pasqyron auditimin e plotë financiar dhe ligjor të situatës financiare në përputhje me ligjet dhe Udhëzimet e kontabilitetit.</p> <p>KU IKT pasqyron në mënyrë transparente të gjitha shpenzimet financiare të faktuara me dokumentacionin/faturat respektive në bilancin vjetor, të cilat reflektohen në lëvizjet bankare të kompanisë.</p> <p>KU IKT financohet nga ortaku i vetëm dhe deri më tani nuk ka përfituar nga grante të jashtëme përveç donacioneve. Çdo detaj i kësaj natyre apo të ardhura të tjera përveç tarifimit të studimit, reflektohet tek zëri/përshkrimi i të ardhurave.</p>
--	--

VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.

<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifatat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>GVJ konstaton se Raportet financiare vjetore të hartuara nga KU IKT dërgohen në institucionet respektive dhe sipas ligjeve dhe dispozitave në fuqi. Të ardhura administrohen dhe menaxhohen sipas buxhetit të miratuar nga investitori për çdo njësi akademike dhe administrative. Raportet pasqyrojnë me detaje dhe transparencë të ardhurat nga tarifatat e studentëve, sipas kontratave të nënshkruara nga palët dhe faturave tatimore për shërbimin e kryer dhe vitet e kërkuara. Qëndrueshmëria financiare dhe kredibiliteti i institucionit për vazhdimin normal dhe të mëtijshëm të tij argumentohet nga buxhetet e miratuara nga investitori ndër vite edhe pse aktiviteti është me humbje. Ndërkohë investitori ka parashikuar në biznes planin e tij që 5 vitet e para nuk parashikon fitim nga aktiviteti i KU "IKT" dhe ka deklaruar që do mbështesë financiarisht "CIT shpk", duke ruajtur cilësinë akademike dhe institucionale.</p>
---	---

Konkluzione të GVJ:
GVJ thekson se nga dokumentacioni i kontrolluar vëren se "CIT shpk" kryen Auditim Financiar të jashtëm çdo vit. Bilanci zyrtar i përvitshëm pasqyron auditimin e plotë financiar dhe ligjor të situatës financiare të "CIT shpk" në përputhje me ligjet dhe udhëzimet e kontabilitetit.

GVJ konfirmon se institucioni ka qëndrueshmëri financiare, bazuar kjo dhe në deklaratën apo letrën e angazhimit të ortakut të vetëm.

Megjithatë, GVJ vëren se një angazhim më i madh institucional duhet në fushën e aplikimit për grante si dhe projekte me të ardhura në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lart në vend apo jashtë Shqipërie. **GVJ sygjeron se duhet të rritet pjesëmarrja e institucionit në projekte të tilla kombëtare si ato që thiren nga AKSHTI apo projekte ndërkombëtare rajonale si IPA, INTEREG apo projekte të BE si HORIZON 2020 etj.**

GVJ gjen se standardet e këtij kapitulli përmbushen plotësisht.

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Piesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njesisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

NJSBC u kontrollua nga grupi i vlerësimit të jashtëm nëpërmjet zyrës përkatëse. Në funksion të sigurimit të cilësisë në KU "IKT" është ngritur një strukturë e qëndrueshme e cila vepron në përputhje të plotë dhe me kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", e cila njihet si Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC).

Në cilësinë e GVJ konfirmojmë se KU "IKT" i ka kushtuar një rëndësi shumë të madhe procesit të cilësisë së edukimit, procedurave për të lehtësuar kualifikimin e stafit akademik, rritjes së cilësisë në zbatimin e standardeve institucionale si dhe proceseve akademike.

Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë e ka nisur punën që në vitin akademik 2012-2013 me Vendim Nr. 16, datë 22. 05. 2013.

GVJ realizoi një takim me NJSBC dhe përgjegjësin e zyrës për kurikulën. të pranishëm në këtë takim ishte drejtuesi i NJSBC Bledar Komina dhe Prof. Vaso Qano. Kryetari i NJSBC bëri një përshkrim të hollësishëm të funksionimit të kësaj zyre që nga koha e krijimit të saj dhe deri më tani. Drejtuesi i zyrës raportoi se institucioni kujdeset që dy fakultetet të kenë përfaqësues në këtë njësi. Me rritjen e numrit të studentëve do kenë përfaqësues edhe nga departamentet. NJSBC organizon pyetësorët mbi cilësinë e mësimdhënjes. Njësia është e fokusuar edhe tek trajnimet të cilat janë të përvitëshme. Kjo njësi ka komunikim të vazhdueshëm me ASCAL me përditësimin e të dhënave nëpërmjet sistemit AMS. Të gjitha vlerësimet kjo zyre ua nis dekanëve të fakulteteve. Njësia pasqyron edhe rastet edhe për vlerësim jo të mirë të pedagogëve nga studentët. Njësia sqaroi se institucioni në vlerësimin e studentëve përdor vlerësimin si me notë dhe me gërmë të njohurive të studentëve edhe për detyrim karshi shtetit shqiptar por edhe vlerësimin me gërma për studentët të cilët synojnë të studiojnë master jashtë vendit. Njësia sqaroi se zbaton politika stimuluese për motivimin e pedagogëve në pune si psh ngarkesa vjetore nuk e ka kaluar asnjëherë shifrën 300 orë apo edhe 260 orë; Realizojnë trajnime të ndryshme; kandidatët për Phd apo për Dr kanë ngarkesë më të ulët; kanë sponsorizuar edhe konferenca ndërkombëtare. Zyra revizionon politikat e rekrutimit por nuk merr pjesë në përzgjedhjen e pedagogëve të rinj.

Kjo njësi konfirmon se nuk kanë patur raste të mitmarjes. Ata mbledhin kërkesa të ndryshme nga studentët, si p.sh për ambjente restoranti apo edhe parkimi. Kjo njësi sqaron se ne hartimin e kurikulës janë mbështetur në udhëzimin nr 15 në ndarjen e lëndëve nga A në F. Tek disiplina e lëndëve bazë janë 4-5 lëndë që kërkojnë laborator. Keto laboratore i përgjigjen këtij programi.

NJSBC sqaron se plani mësimor është marrë nga jashtë dhe është përshtatur. Ky program është konceptuar që kandidati që përfundon studimet e plota të jetë jo vetëm një inxhinier i përgjithshëm, por të jetë edhe një menaxher i mirë. Ky program është marrë nga Kanadaja si program 4 vjeçar dhe është përshtatur si 3 vjeçar. Gjatë viteve, NJSBC është angazhuar në proceset e sigurimit të cilësisë në institucion si dhe në proceset e akreditimit institucional apo atij programor. Kështu që nga viti 2014, NJSBC është angazhuar në organizimin dhe mbarëvajtjen e akreditimit institucional që rezultoi i suksesshëm për vitin akademik 2015-2016, vit në të cilin KU "IKT" u akreditua institucionalisht prej APAAL dhe MAS. Ndërkohë që po atë vit KU "IKT" akreditoi edhe 6 programe të ciklit të parë dhe të dytë. Në të gjitha këto procese, NJSBC u angazhua me stafin akademik për të përcjellë frymën e pëmbushjes së cilësisë, deklarimeve reale si dhe për të mbështetur stafin akademik në këtë rrugë të gjatë institucionale. Njëkohësisht edhe në vitin akademik 2016-2017, NJSBC bashkë me stafin akademik u angazhuan në procesin e akreditimit sërish institucional me agjencinë britanike

QAA, proces i realizuar prej APAAL dhe MAS së asaj kohe. Edhe ky proces rezultoi i suksesshëm, duke arritur që KU “IKT” të akreditohet prej ASCAL në 2017 për një periudhë 5 vjeçare .

Përbërja e NJSBC

Në bazë të Statutit të KU “IKT”, NJSBC është struktura e brendshme e përhershme e cila është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është organ kolegjal. Ajo përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët 2 (dy) janë përfaqësues të personelit akademik të njësive kryesore (një për secilën njësi); 1 (një) personel i administratës; 1 (një) përfaqësues i Këshillit Studentor; dhe 1 (një) *ekspert* që drejton njësinë. **Ne në cilësinë e GVJ morëm takim me të gjithë anëtarët e njësisë.** Anëtarët e Njësisë miratohen nga Senati Akademik me propozim të Rektorit, me mandat 4 vjeçar. Kryetari i njësisë, propozohet nga Rektori dhe miratohet në Senatin Akademik. **Informacioni i raportuar në RVB lidhur me kompetencat e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë u gjet i sakte nga ana jonë në cilësinë e GVJ. Po kështu ne konfirmojmë se informacioni me të dhëna për anëtarët e NJSBC-së së IKT është i saktë. Përbërja e NJSBC shiko Aneksë, tabela 12**

Manuali i Sigurimit të Cilësisë

Një prej dokumenteve më të rëndësishme të NJSBC ishte edhe “Manuali i Sigurimit të Cilësisë” në institucion i njohur ndryshe edhe si “*QAU Handbook*”. Ai rishikohet prej NJSBC, dhe ishte në përputhje me standardet dhe kriteret e cilësisë që kërkohen jo vetëm ndërkombëtarisht por dhe në KU “IKT”. Manuali miratohet çdo vit nga Senati Akademik, në fillim të vitit dhe shpërndahet për stafin akademik, të cilit i kërkohet që t’i përmbahen rigorozisht. Ky manual gjendet online në shërbimin *My CIT* në faqen e uebit të IKT dhe është i aksesueshëm prej stafit akademik në çdo kohë. **Ne bëmë një verifikim të këtij manuali online dhe rezultoj se ishte i aksesueshëm.** Në shërbim të funksionimit sa më mirë të NJSBC në Librin e Rregulloreve Institucionale gjendet edhe rregullorja e funksionimit të njësisë, në të cilën jepen detaje mbi procedurat e punës, objektivat si dhe mjetet që përdoren për ruajtjen e cilësisë në institucion. **Pyetësorë të organizuar ndër vite u kontrolluan nga ana jonë dhe rezultuan të saktë.** Pyetësorët janë organizuar në përfundim të çdo semestri, për të gjitha programet e studimit, për të gjitha ciklet, për të gjitha lëndët dhe pedagogët.

Rezultatet e para të pyetësorëve janë përpunuar tërësisht nga ana e personave përgjegjës për statistikën, ndërsa rezultatet e fituara në fazën finale janë vënë në dispozicion të drejtuesve të institucionit, si edhe në mënyrë të personalizuar për secilin pedagog. Ndër problemet më kryesore kanë qënë, ato lidhur me literaturën e rekomanduar, shfrytëzimin e orës së mësimi, cilësinë në shpjegim dhe kontroll, etj. Në varësi të rezultateve ndërtohet dhe pritshmëritë si dhe veprimtaria e rektoratit dhe dekanëve për pedagogët që mund të mos kenë pasur një performancë të pëlqyeshme. Të gjitha raportet e vetvlerësimit bashkë me të dhënat e pyetësorëve përdoren për të ndërtuar panoramën e situatës brenda institucionit mbi procesin e mësimdhënies, funksionimit të njësive bazë, kërkimit shkencor si dhe kontributit për çështje administrative nga ana e stafit akademik.


Fusha dhe hapësira e kontributit të NJSBC në IKT

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në KU “IKT” ka një rol shumë të rëndësishëm në përmbushjen e misionit të saj brenda institucionit si dhe në bashkëpunim me agjencitë publike. Ajo është garantuese e ndjekjes së proceseve për ruajtjen dhe certifikimin e cilësisë dhe në bashkëpunim me APAAL (ASCAL) ka kryer akreditimin e institucionit si koordinatore e procesit dhe atë të disa programeve në IKT.

Për të dhënat e mësipërme, GVJ është mbështetur në RVB por edhe gjatë takimit që realizoi në Institucion me NJSBC

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
---------------------	--------------------------



II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE
Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.

Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;

Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;

Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:

Të tërthorta:

- Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve;
- Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit;
- Pyetje konceptuale;
- Intervista;
- Etj.

Të drejtpërdrejta:

- Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara);
- Dëgjime në auditor;
- Vlerësimi me nota/pikë;
- Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë;
- Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet);
- Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;
- Etj.

Nga vëzhgimet tona në cilësinë e GVJ rezultojnë se IKT përdor metodologji vlerësimi dhe instrumente matëse për ecurinë dhe mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies, cilësisë së literaturës së përdorur, teknikave pedagogjike të përdorura nga pedagogët etj., si dhe për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit. Këto metodologji, instrumenta dhe procedura të tjera në i gjetëm të materializuara në NJSBC si edhe në takimet që realizuam me Dekanin dhe me Rektorin. Aktiviteti i monitorimit organizohet nga NJSBC, për secilin nga proceset akademike që kontrollohen gjatë vitit dhe rezultatet e tyre i raportojnë pranë Rektoratit dhe Dekanateve të fakulteteve.

Informacioni për metodologjinë e vlerësimit dhe rezultatet e instrumentave matëse përfshiheshin në raportin e vetëvlerësimit të cilën në e gjetëm në NJSBC. Kjo procedurë mbështetet mbi vetdeklarimin në bazë të pyetsorëve në rastin e studentëve; dhe në rastin e stafit akademik e administrativ, pyetsorët dhe vetvlerësimin. Rezultatet e pyetsorëve janë indikatorë të fuqishëm vetërregullues.

Për grumbullimin e informacionit, sic përmendëm, IKT përdor pyetsorët si metodë e drejtpërdrejtë dhe takimet dhe tryezat e bashkëbisedimit me studentët dhe grupet e interesit si metodë e tërthorët. Gjithashtu konstatojmë se përdoret edhe teknika e raportimit për njësinë kryesore për dekanin dhe njësinë bazë për përgjegjësin e departamentit si edhe ajo e vetdeklarimit nga ana e stafit akademik me kohë të plotë apo të pjesëshme për detyrat akademike vjetore që ata realizojnë apo edhe për detyrat administrative. IKT realizon edhe analizen vjetore të procesit mësimor ku shihet dhe analizohet me hollësi kalueshmëria e studentëve; frekuentimi i tyre, nota mesatare; rezultatet e larta, mos frekuentimin apo dhe përqindjen e atyre që ngelin. Të dhëna këto që tregojnë për ecurinë e procesit mësimor. Një analizë e detajuar e këtyre të dhënave reflektohet në raportet vjetore që njësitë kryesore dorëzojnë pranë rektoratit. **Ne kontrollojmë raportin e analizës së punës mësimore për vitin e kaluar akademik ku analizoheshin këto problematika.**

Pyetsorët janë organizuar në fund të cdo semestri studimi, për cdo lëndë të programit mësimor.

	<p>Pyetsorët përmbanin pyetje të tilla si përmbajtja e syllabusit ishte në përputhje me prishmëritë e studentëve; literaturë e përdorur online dhe hardcopy a ishte në dispozicion të studentëve; për përgatitjen e pedagogeve gjate zhvillimit të leksionit; fillimin dhe mbarimin në orar të mesimit nga ana e padagogut; kërkesat e stafit për institucionin; shërbimet që ofrohen etj. Konstatuam se organizimi dhe përmbajtja e pyetsorëve i përgjigjet kërkesave që shtrohen për një institucion të arsimit të lartë për akreditim dhe ishin sipas standarteve europiane të arsimit të lartë.</p>
--	--

VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË
Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.



<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>IKT si institucion është i akredituar. Institucioni garanton cilësinë në të gjitha nivelet dhe kjo arrihet nëpërmjet cilësisë së planeve dhe programeve mësimore; cilësisë së stafit nëpërmjet kualifikimit të tyre në marrjen e gradave dhe titujve shkencore; kualifikimit të stafit administrative dhe gjithë hallkave të tjera të një programi mësimor. Kontrolli i sigurimit të cilësisë realizohet nga ana e strukturave drejtuese dhe NJSBC, tërheqjes së mendimit të studentëve, të stafit akademik si dhe bashkëpunimi me struktura e fakultetit. Në funksion të cilësisë së mësimdhënies është edhe kontrolli i brendshëm i performancës së stafit akademik. Ky kontroll synon arritjen e objektivave dhe standardeve bashkëkohore, që garantojnë transmetimin e dijeve dhe njohurive dhe zbatimin e metodologjisë bashkëkohore në formimin e studentëve.</p> <p>NJSBC realizon vlerësimin e performancës së cdo pedagogu nëpërmjet pyetsoreve; vetëvlerësimit; vlerësimit nga ana e eprorëve jo vetëm për performancë akademike por edhe atë administrative.</p>
---	--

Konkluzione të GVJ:

GVJ konstatoi se sigurimi i brendshëm i cilësisë realizohet në IKT nga NJSBC nëpërmjet zyrës përkatëse. Në funksion të sigurimit të cilësisë në KU "IKT" është ngritur një strukturë e qëndrueshme e cila vepron në përputhje të plotë dhe me kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", e cila njihet si Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC).

Në cilësinë e GVJ konfirmojmë se KU "IKT" i ka kushtuar një rëndësi shumë të madhe procesit të cilësisë së edukimit, procedurave për të lehtësuar kualifikimin e stafit akademik, rritjes së cilësisë në zbatimin e standardeve institucionale si dhe proceseve akademike.

GVJ vërejt se KU "IKT" Sigurimit të cilësisë në institucion i kushton një kujdes të veçantë, duke e konsideruar prioritet për secilin punonjës, ai ndiqet me kujdes nga strukturat drejtuese dhe monitorohet në mënyrë permanente nga NJSBC.

Ne në cilesine e GVJ morëm takim me të gjithë anetarët e njesise. Anëtarët e Njesisë miratohen nga Senati Akademik me propozim të Rektorit, me mandat 4 vjeçar. Kryetari i njesisë, propozohet nga rektori dhe miratohet në Senatin Akademik. **Informacioni i raportuar ne RVB lidhur me kompetencat e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë u gjet i saktë nga ana jonë në cilesinë e GVJ**

Një prej dokumenteve më të rëndësishme të NJSBC ishte edhe “Manuali i Sigurimit të Cilësisë” në institucion i njohur ndryshe edhe si “*QAU Handbook*”. Ai rishikohet prej NJSBC, dhe ishte në përputhje me standardet dhe kriteret e cilësisë që kërkohen jo vetëm ndërkombëtarisht por dhe në KU “IKT”. Manuali miratohet çdo vit nga Senati Akademik, në fillim të vitit dhe shpërndahet për stafin akademik, të cilit i kërkohet që t’i përmbahen rigorozisht. Ky manual gjendet online në shërbimin *My CIT* në faqen e uebit të IKT dhe është i aksesueshëm prej stafit akademik në çdo kohë. **Ne bëmë një verifikim të këtij manuali online dhe rezultoj se ishte i aksesueshëm**

GVJ gjen se standardet e këtij kapitulli përmbushen plotësisht.

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Programi Bachelor në Inxhinierinë Industriale është hartuar me qëllim që të përgatisë studentët për një karrierë të sukseshme në industrinë dhe teknologjinë e informacionit dhe manaxhimit industrial dhe atij ekonomik. Ky program afron një qasje sistematike për të përmirësuar produktivitetin dhe efikasitetin në botën e biznesit dhe sidomos atë të prodhimit industrial. Qëllimi i këtij programi është përftimi i njohurive të studentëve në shkencë bazë si (matematikë, fizikë) si edhe të frymëzojë dhe të transmetojë tek studentët një informacion sa më bashkëkohor aq edhe cilësor në mënyrë të tillë që studenti të konkludojë në mënyrë të pavarur, duke u fokusuar në optimizimin e proceseve, duke bërë më shumë me më pak, si edhe tju japë mundësi studentëve të vazhdojnë rritjen e tyre akademike si në nivelin master ashtu edhe në doktoraturë si brenda dhe jashtë vendit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Qëllimi i këtij programi është përftimi i njohurive të studentëve në shkencë bazë si (matematike, fizikë etj) edhe ekonomike manxheriale, analizës ekonomike si edhe atyre digitale, duke afruar një qasje në mënyrë sistematike në përmirësimin e efikasitetit dhe produktivitetit prodhimtar dhe atij manaxherial.

Qëllimi jo vetëm i këtij programi mësimor por i të gjithë KUIKT është të frymëzojë dhe të transmetojë tek studentët një informacion sa më bashkëkohor aq edhe cilësor në mënyrë të tillë që studenti të konkludojë në mënyrë të pavarur.

Programi bachelor ne Inxhinierinë Industriale është lincësuar në vitin 2011 me VKM, dhe sipas Urdhërit të MASH për të filluar në vitin akademik 2011-2012.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- 1 vit akademik ka **30 javë** mësimore në auditor, përjashtim bën viti I tretë I cili ka 26 javë në auditor dhe **4 jave** praktikë profesionale.
- 1 Semestër ka **15 javë** mësimore në auditor,

Planet mësimore, ku të jepet ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

(Shënim: Planin mësimor i gjetur nga GVJ është i njëjti me planin mësimor të paraqitur në RVB por edhe si ankes në DVV)

Në planet mesimore të kontrolluara prej nesh por edhe në ato të RVB jepet në mënyrë të detajuar ndarja e ECTS sipas formave të cdo lende. Jepej në mënyrë të detajuar sa pike ka lesioni, sesa ka seminare apo laborator.

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

▪ Për leksionet	894 orë në auditor dhe	1279 orë punë e pavarur e studentit
▪ Për Seminaret	192 orë në auditor dhe	408 orë punë e pavarur e studentit
▪ Për Labororet	342 orë në auditor dhe	133 orë punë e pavarur e studentit
▪ Për Praktikat lëndore	38 orë në auditor dhe	437 orë punë e pavarur e studentit
▪ Për Praktikën Profesionale	120 orë në auditor dhe	30 orë punë e pavarur e studentit
▪ Provimi përfundimtar	0 orë në auditor dhe	150 orë punë e pavarur e studentit

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara

Gjate vizitës dhe kontrollit të bërë nga ana jonë u konstatua se gjatë viteve ishin bërë disa ndryshime të lëndëve të ndryshme, si në përmbajtje ashtu edhe në emërtim. Këto ndryshime ishin të paraqitura si në syllabus ashtu edhe në RBV si më poshtë:

1. Lënda Communication Skills ishte bërë Academic Reading and Writing I.
2. Lënda Creative Thinking ishte bërë Academic Reading and Writing II
3. Lënda Digital Logic ishte me zgjedhje ishte e bërë e detyruar.

Këto ndryshime në total ishin 18 ECTS=10% te totalit te përgjithshëm të Bsc

Shiko Anekse Tabela 14

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës

Shiko Anekse, Tabela15 Planin mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Analiza e cilësisë së syllabuseve

Syllabuset e kontrolluara nga ana jonë si edhe ato që pedagogët e IKT kishin raportuar në RBV ishin të mirë të detajuara, të programuara si edhe të mirë trajtuara si nga ana leksiko-seminareske por edhe nga ato laboratorike. Ato jepnin një informacion të saktë dhe të detajuar për studentin si edhe për cilindo që do të dëshironte ti asistonte në ëeb faqen e universitetit. Ato ishin të pajisuara me një literaturë bashkëkohore evropiane dhe amerikano veriore.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA	
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Të gjitha programet e KU IKT ishin në përputhje me legjislacionin shqiptar, të akredituara dhe të mirë organizuara në module dhe lëndë të vlerësuara sipas STGK në kredite sipas normave.</p> <p>Sasia e krediteve ishte e plotë 180 kredite për gjithë programin e Bachelorit të Inxhinierise Industriale, ku secili prej viteve kishte një sasi prej 60 kreditesh.</p>
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.	
<p>Kriteri 1 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;</p> <p>Kriteri 3 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;</p> <p>Kriteri 4 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikatat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.</p>	<p>GVJ konstatoi se Njësitë kryesore përgjegjëse për programin e studimit japin informacion për përmbajtjen e programeve të studimit. Ky informacion ju jepej studenteve që ditën e parë të hyrjes në IKT, si edhe ju mundësohej edhe kandidatëve për student me një lehtësi duke u aplikuar I afishur on line në faqen e ëebit të IKT. Informacioni jepej i detajuar si për lëndët bazë ashtu edhe për ato me zgjedhje. Gjithashtu studentëve ju sigurohej informacion mbi mënyrën e zbatimit apo shpjegimit në auditore sipër lëndet teorike ashtu edhe për ato aplikative, si për leksionet dhe seminarat ashtu edhe për laboratorët dhe detyrat praktike.</p> <p>Ky informacion jepej në fillim viti, ashtu edhe cdo fillim semestri, si për ngarkesën në auditor ashtu edhe jashtë tij.</p> <p>Tregues vlerësues ishte informacioni që ju jepej student I detajuar për pikezimin e lendeve si edhe për frekuentimin si duhej bere në orët e leksioneve ashtu edhe në ato seminarike dhe laboratoeve</p> <p>Gjithashtu cdo fillim semestri pedagogët sqaronin në mënyrë të vecantë se sesi dhe sesa studentit I duhej të punonte jo vetëm për shlyerjen e provimeve të detyruara por edhe të praktikave mesimore dhe sidomos për punët dhe detyrat e kursit, qoftë për ato individuale qoftë për ato në grup.</p>
<p>Konkluzionet e GVJ: GVJ gjykon dhe vlerëson se IKT ju jep studentëve të Bachelor në Inxhinieri Industriale një informacion të bollshëm, të detajuar si edhe të nevojshëm në lidhje me programin e studimit në të gjitha lëndët dhe modulet mësimore të tij. Ky informacion që lehtësisht I gjendëshëm dhe lehtësisht I asistueshëm nga të gjithë studentet, si edhe ai ju servirej studentëve jo vetëm cdo fillim viti por edhe cdo fillim semestri. Lëndët e ofruara nga IKT për këtë program mësimor ishin conform urdhrave dhe udhëzimeve të MASH si edhe ato përmbanin një pikëzim dhe vlerësim sipas STGK sistemit europian të transferimit dhe grumbullimit të krediteve. Gjithashtu në vumë re se në zbatimin e programit kishte një shpërndarje të mirëvlersuar të pikëve kundrejt leksioneve, seminareve, detyrave të kursit dhe të laboratorëve.</p>	

